



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

STUDIM MBI PROMOVIMIN E DIVERSITETIT DHE BARAZISË



Qershor 2021

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

*Titulli i dokumentit në gjuhën Angleze:
"Study on promotion of diversity and equality"*

Ky studim u krye për nevojat e Zyra për Qeverisje të Mirë, të drejtat e njeriut, mundësi të barabarta dhe kundër diskriminim.

Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të asnjërës palë.

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon "©Këshilli i Evropës, viti i botimit". Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë publikim duhet t'i drejtohen Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit.

@ Këshilli i Evropës, Qershor 2021. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I liçencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara.

Autori i këtij raporti është UBO Consulting



Parathënie

Ky sondazh për “Modelet e diskriminimit në Kosovë” është rezultat i bashkëpunimit shumë të mirë ndërmjet Zyrës së Kryeministrit/Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe Zyrës së Këshillit të Evropës në Kosovë¹, në kontekst të programit të Mekanizmit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë të BE-KE.

Dokumenti synon të matë perceptimin e përgjithshëm të popullatës në Kosovë lidhur me praninë e diskriminimit në shumë aspekte të jetës së tyre, përfshirë ndikimin e pandemisë së COVID-19. Ai mbulon çështje të diskriminimit dhe të grupeve në nevojë që janë relevante për punën dhe standardet e Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, organi anti-diskriminim i Këshillit të Evropës.

Rezultatet e sondazhit pasqyrojnë arritjet e dhe sfidat me të cilat përballen institucionet për të siguruar gëzimin e plotë dhe të barabartë të të drejtave të njeriut të individëve dhe në veçanti, mbrojtjen kundër diskriminimit në të gjitha aspektet e jetëve të tyre. Sondazhi shërben si matje për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe do t’i ndihmojë institucioneve të Kosovës të zhvillojnë politika dhe veprime në përputhje me nevojat e paraqitura.

Institucionet e Kosovës dhe sidomos Zyra për Qeverisje të Mirë do t’i përdorin të dhënat e këtij hulumtimi si orientim gjatë planifikimit të prioritetëve të përbashkëta për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin.

Ky hulumtim përmban një gamë të gjerë të rekomandimeve, përfshirë krijimin dhe fuqizimin e mekanizmave në të gjitha nivelet institucionale për zbatimin dhe monitorimin e Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Dëshirojmë t’i shprehim mirënjohjen tonë të gjithë partnerëve tanë për përpjekjet e tyre të palodhshme që të arrihen rezultate për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët në Kosovë, pavarësisht gjinisë, gjuhës, fesë, origjinës etnike, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar dhe statusit tjetër personal të tyre.

Habit HAJREDINI

Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë
Zyra e Kryeministrit në Kosovë

Frank POWER

Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës
Kosovë

PËRMBAJTJA

1. Përmbledhje ekzekutive	5
1.1. Gjetjet kryesore	5
2. Hyrje	7
3. Metodologjia	Error! Bookmark not defined.
3.1. Dizajnimi i mostrës.....	8
3.2. Madhësia e mostrës	8
3.3. Finalizimi i pyetësorit.....	9
3.4. Rekrutimi dhe trajnimi i ekipit të sondazhit	9
3.5. Puna në terren dhe kontrolli i cilësisë.....	9
3.6. Pastrimi i të dhënave, tabulimi dhe analizimi.....	10
4. Rezultatet nga studimi “Promovimi i diversitetit dhe barazisë në Kosovë”	10
4.1. Profili demografik i të anketuarve	10
4.2. Perceptimi i përgjithshëm për diskriminimin në Kosovë.....	10
4.3. Kontributi i palëve të interesit në luftën kundër diskriminimit.....	23
4.4. Efektet e COVID-19 mbi modelet e diskriminimit.....	32
5. Konkluzionet	Error! Bookmark not defined.

1. Përmbledhje ekzekutive

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, zhvilloi studimin mbi “Promovimin e diversitetit dhe barazisë në Kosovë” ky studim u realizuar nga UBO Consulting. Studim synonte të identifikojë perceptimin e publikut të përgjithshëm dhe përvojat direkte me shkeljen e të drejtave të njeriut, si dhe njohuritë e tyre dhe vlerësimin për punën e institucioneve për të drejtat e njeriut në Kosovë.

Ky studim përfshiu në total 1,065 intervista individuale në të 38 komunat e Kosovës, duke përbërë kështu një mostër përfaqësuese të vendit.

1.1. Gjetjet kryesore

- Në total, pothuajse gjysma e të anketuarve (48%) kanë thënë se besojnë që diskriminimi është i pranishëm në masë të moderuar/të madhe në Kosovë. Të shpërndarë sipas etnisë, shqiptarët e Kosovës (shqiptarët-K) (48%) kanë thënë se diskriminimi ishte i pranishëm në masë të moderuar/të madhe dhe 52% e boshnjakëve të Kosovës, romëve të Kosovës, ashkalinjve të Kosovës, egjiptianëve të Kosovës, turqve të Kosovës, goranëve të Kosovës (të tjerë-K) kanë thënë të njëjtën, ndërkohë që vetëm 29% e serbëve-K ndajnë të njëjtin mendim.
- Një numër i barabartë i qytetarëve kanë deklaruar se diskriminimi është më mbizotërues mbi baza gjinore dhe etnike (19% për secilën bazë), ndjekur nga mendimi politik (16%), niveli i arsimimit dhe i të ardhurave (14%) dhe mosha (11%).
- Më shumë gra (27%) se sa burra (12%) besonin se diskriminimi kryesisht ndodh mbi baza gjinore. Nga ana tjetër, më shumë burra (19%) se sa gra (13%) besojnë se diskriminimi është rezultat i mendimeve të ndryshme politike.
- Punësimi konsiderohet si një nga sferat me mbizotërimin më të madh të diskriminimit (59%).
- Vetëm 9% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë qenë viktimat të diskriminimit në 12 muajt e fundit, nga të cilët 36% e kanë patur atë përvojë në vendin e punës. Kur u pyetën për veprimet që kanë ndërmarrë kundër aktit të diskriminimit, shumica e tyre (67%) pohuan se nuk kanë bërë asgjë.
- Më shumë të tjerë-K (15%) se sa shqiptarë-K (9%) dhe serbë-K (8%) thanë se kanë qenë viktimat të diskriminimit në 12 muajt e fundit për shkak të etnisë së tyre.
- Më pak se gjysma e të anketuarve (44%) raportuan se nuk kanë dijeni për të drejtat e tyre në raste të diskriminimit. Nga aspekti i etnisë, vetëm 10% e serbëve-Ku përgjigjën pozitivisht, ndërsa 46% e shqiptarëve-K dhe 33% e të tjerëve-K u përgjigjën njësoj.
- Më shumë se gjysma e të anketuarve (54%) kanë deklaruar se do t'i drejtoheshin policisë dhe 24% e tyre thanë se do t'i drejtoheshin Gjykatave.
- Kur u pyetën për përvojat e tyre personale me diskriminimin, padrejtësinë apo trajtimin e keq mbi baza të ndryshme në çfarëdo kohe gjatë jetës së tyre, 20% e të anketuarve u deklaruan se u është mohuar ndonjë vend pune për shkak të gjinisë, nacionalitetit, fesë,

besimit politik, moshës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual etj., ndërsa 16% prej tyre deklaruan se nuk u janë dhënë të njëjtat mundësi si të tjerëve në fushën e arsimit për shkak të të njëjtave baza.

- Shumica (67%) e të anketuarve deklaruan se diskriminimi kishte ndërhyrë disi/pak që ata të kishin jetë të përmbushur dhe produktive.
- Më shumë se gjysma e të anketuarve (57%) raportuan se nuk ishin në dijeni për Ligjin nr.05/l-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Përkundrazi, 57% e tyre deklaruan se ishin të familjarizuar me Avokatin e Popullit, ku më shumë se gjysma e tyre (55%) deklaruan se do të ishin disi/shumë të gatshëm t'i raportonin rastet e diskriminimit tek ky i fundit.
- Vetëm 19% e të anketuarve deklaruan se ka patur disi/shumë përpjekje të investuara në luftën kundër diskriminimit.
- Në një shkallë nga 1 deri 5, ku 1 është më e ulët dhe 5 më e lartë, media (3.05) dhe Organizatat Ndërkombëtare (3.04) u vlerësuan më lart kur u pyetën për masën në të cilat institucionet japin kontributin e tyre në luftën kundër diskriminimit.
- Shumica e të anketuarve (74%) besonin se institucionet e Kosovës e mbrojnë mirë komunitetin serb nga diskriminimi, ndërsa më pak të anketuar (56%) thanë të njëjtën për komunitetin rom.
- Në total 40% e të anketuarve deklaruan se kishin disi/aspak besim tek shteti kur ishte fjala për mbrojtjen e tyre nga diskriminimi. Grupi më i diskriminuar konsideroheshin të varfërit (3.94), ndjekur nga të moshuarit (3.84) dhe gratë (3.79).
- Shumica e të anketuarve (83%) besonin se diskriminimi në punësim kryesisht mbështetje mbi besimet politike dhe 77% e tyre besonin se bazohej mbi gjini.
- Në total 24% e të anketuarve besonin se numri i rasteve të diskriminimit gjatë pandemisë së COVID-19 është rritur, sidomos ndaj të varfërve (43%) dhe grave (41%).

2. Hyrje

Në shtator 2020, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, angazhoi UBO Consulting për të bërë një studim për Promovimin e Diversitetit dhe Barazisë në Kosovë. Studimi synonte të zhvillonte të dhëna statistikore në nivel nacional lidhur me çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen kundër diskriminimit, që është brenda mandatit të Zyrës për Qeverisje të Mirë, sipas Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Qëllimi kryesor i hulumtimit ishte të kuptojë më mirë perceptimin e publikut për diskriminimin dhe përvojat individuale me shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë, si dhe njohuritë dhe vlerësimin që kanë për punën e institucioneve për të drejtat e njeriut në Kosovë. Më tutje, ky studim ka vlerësuar gjendjen e përgjithshme lidhur me modelet e diskriminimit në Kosovë dhe ka vlerësuar ndikimin që ka patur shpërthimi i COVID-19 mbi këto modele.

Së fundmi, të dhënat e mbledhura nga ky studim do t'i udhëzojnë të gjitha institucionet relevante, përfshirë Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit, në implementimin efikas të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligjin nr. 05 / L-019 për Avokatin e Popullit dhe Ligjin nr. 05 / L-020 për Barazinë Gjinore (e ashtuquajtura pako e ligjeve për të drejtat e njeriut) që janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 qershor 2015. Me këtë pako, Republika e Kosovës ka krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse të legjislacionit vendor që mishëron Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Direktivat e Këshillit dhe të Parlamentit të Bashkimit Evropian.²³

Për këtë detyrë, agjencia UBO Consulting i asistoi Këshillit të Evropës me këshilla teknike lidhur me dizajnimin, zhvillimin dhe kryerjen e studimit. Përkatësisht, detyrat kryesore të agjencisë përfshinin:

- Përgatitjen e instrumentave për hulumtim
- Propozimin e metodave dhe procedurës për mbledhjen e të dhënave
- Zhvillimin e intervistave sy më sy (anketimi)
- Zhvillimin e analizimit të të dhënave
- Hartimin e raportit të përgjithshëm
- Hartimin e prezantimit me gjetjet

² GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 16 / 26 QERSHOR 2015, PRISHTINA nxjerrë më 25 shtator 2020 nga: https://equineteurope.org/wp-content/uploads/2019/10/Annex-LAW_NO_05_L_021_ON_THE_PROTECTION_FROM_DISCRIMINATION.pdf

³ Lista e plotë e traktateve të Këshillit të Evropës që u nxor më 19 tetor 2020 nga: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list>

Ky dokument paraqet rezultatet e nxjerra nga një mostër totale prej **1,065 të anketuarish**. Për më tepër, përfshin qasjen metodologjike, instrumentat, pastrimin dhe analizimin e të dhënave. Edhe konkluzionet nga rezultatet e këtij studimi janë pjesë e këtij raporti.

3. Metodologjia

Për qëllime të këtij studimi, UBO Consulting ka përdorur qasjen sasiore të hulumtimit, në mënyrë që të masë perceptimet për diskriminim dhe përvojat individuale me shkeljen e të drejtave të njeriut, si dhe njohuritë dhe vlerësimin e tyre për punën e institucioneve për të drejtat e njeriut në Kosovë. Pyetësi përmbante 41 pyetje, 12 nga të cilat ishin pyetje demografike. Gjithashtu, u dhanë edhe përshkrime për konceptet me të cilat të anketuarit kishin mundësi të mos ishin të familjarizuar, në mënyrë që ata ta kishin të plotë kuptimin e tyre.

3.1. Dizajnimi i mostrës

Pyetësi “Promovimi i diversitetit dhe barazisë në Kosovë” u administrua përmes intervistave sy më sy, duke përdorur teknikën e intervistimit personale të asistuar nga kompjuteri (CAPI). Teknika CAPI siguron që të ketë më pak gabime dhe cilësi më të lartë të të dhënave, që është dhe metoda kryesore për të siguruar vlefshmërinë e studimit. Ky sondazh është zhvilluar në 38 komuna në të gjithë Kosovën, ku përfshiheshin shqiptarë-K, serbë-K dhe të tjerë-K që jetojnë në Kosovë. Për serbët e Kosovës dhe komunitetet e minoriteteve të tjera u përdor qëllimisht mostër më e lartë që të mundësonte analizë krahasimore sipas etnive të ndryshme. Përveç etnisë, seti me të dhëna u peshua edhe në bazë të moshës së të anketuarve, për ta pasqyruar popullatën saktësisht. Të anketuarit u përzgjedhën në mënyrë rastësore, duke ecur dhe duke zgjedhur çdo të tretën shtëpi në anën e majtë të rrugës. Intervistat u zhvilluan me të anketuarit që ishin më të moshuar se 18 vjeç dhe që kishin ditëlindjen më të përafërt në atë familje.

3.2. Madhësia e mostrës

Hulumtimi në fjalë përfshin në total **1,065 të anketuar** në të gjitha 38 komunat në Kosovë, me përbërje totale prej 92% shqiptarë-K, 4% serbë-K dhe 4% përfaqësues nga komunitetet e tjera etnike në Kosovë. Për të siguruar mbledhje të saktë dhe pa paragjykim të të dhënave, sondazhet u kryen duke përdorur mostrën rastësore brenda popullatës së përgjithshme të synuar. Për më tepër, korniza e mostrës për këtë sondazh përfaqësues nga i gjithë vendi u bazua në të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë më të fundit (2011) për të pasqyruar shpërndarjen e madhësisë, gjinore, etnike dhe gjeografike të popullsisë, për t’u siguruar që rezultatet e përfaqësojnë popullsinë me saktësi. U përcaktuan kuotat e sakta për të gjitha nëngrupet e komuniteteve etnike për secilën komunë në bazë të metodës PPS (probabiliteti

proporcional me madhësinë) dhe ato iu shpërndanë anketuesve tanë, duke siguruar përfaqësim për secilin grup. Përfaqësimi i grupeve minoritare u siguroi përmes mostrave më të mëdha dhe peshës së variablave, kudo që kjo ishte e mundur dhe e nevojshme.

Kjo mostër është përlogaritur duke marrë parasysh nivelin e besimit prej 95% dhe marginën e gabimit prej 3% për të gjithë mostrën dhe është përfaqësuese për popullatën e synuar.

3.3. Finalizimi i pyetësorit

Për të identifikuar problemet e mundshme që mund të lindin gjatë kryerjes së intervistave në terren, UBO Consulting zhvilloi një test-pilot të pyetësorëve për t'i vërtetuar ato sa i përket përmbajtjes dhe logjikës. Testi pilot gjithashtu mundësoi përcaktimin e vlefshmërisë (shkallën në të cilën pyetësi mat atë që supozohet të masë) dhe besueshmërinë (konsistenca e përgjithshme e brendshme) e pyetësorit. Gjatë kësaj faze u bënë ndryshimet e nevojshme, përfshirë: redaktimin ose riformulimin e pyetjeve, shtimin e filtrave në pyetje të caktuara, etj. Së fundmi, versioni përfundimtar i pyetësorëve të sondazhit u përpilua në tri gjuhë: anglisht, shqip dhe serbisht

3.4. Rekrutimi dhe trajnimi i ekipit hulumtues

Ekipi u përzgjedh me kujdes, duke i dhënë përparësi hulumtuesve me përvojë. Ekipi i punës në terren përbëhej nga 23 anketues, dy mbikëqyrës në terren, një kontrollues teknik dhe një koordinator i terrenit. Mbikëqyrësi i punës në terren mundësonte mbikëqyrjen në të gjitha rajonet që anketohen. Më 2 shtator në sallën e trajnimeve të UBO Consulting u organizuan sesione trajnimi.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte të sigurohej që anketuesit t'i kuptonin plotësisht pyetjet e sondazhit, të ishin të familjarizuar me metodologjinë e marrjes së mostrave dhe intervistave, dhe të ishin intervistues efektivë dhe të mund t'i administronin intervistat me lehtësi, saktësi, konsistencë dhe natyrshmëri.

3.5. Puna në terren dhe kontrolli i cilësisë

UBO Consulting e zhvilloi punën në terren për sondazhin ndërmjet 03 dhe 23 shtator. Sondazhi u zhvillua me përfaqësues të shqiptarëve-K, serbëve-K dhe komuniteteve të tjera joshumicë-K, të moshës 18 vjeçare dhe më të rritur dhe u zhvillua si në zonat urbane, ashtu edhe rurale, njëjtë.

Për të arritur mbikëqyrje efektive dhe për të siguruar cilësinë, mbikëqyrësit e terrenit bënë edhe kontrollin e cilësisë. Ata ishin përgjegjës për të bërë kontrollin e parë të cilësisë duke kontrolluar çdo pyetësor të paraqitur dhe personelin për regjistrimin e të dhënave,

përgjegjës për të bërë nivelin e dytë të kontrollit të cilësisë, duke kontrolluar ndërkohë të dhënat në databazën elektronike.

Procedura standarde për sigurimin e cilësisë së UBO Consulting është rikontrollimi i 1/3 së mostrës. 30% e të anketuarve u kontaktuan përsëri me telefon për të verifikuar dhe vërtetuar të dhënat. Ky proces siguroi vërtetësinë e rezultateve dhe ruajti drejtësinë e kërimit.

3.6. Pastrimi i të dhënave dhe analizimi

Pastrimi dhe analizimi i të dhënave për studimin sasior u realizua në SPSS dhe tabelat u gjeneruan sipas planit të analizës që u finalizua nga ekipi i hartimit të raportit. Profesionistët tanë me përvojë në vlerësimin e të dhënave siguruan që të dhënat nuk përmbanin asnjë kod të padëshiruar, gabime, mospërputhje apo të mungonin të dhëna.

U bë ritabulimi për të zbuluar ndërlidhjen midis të dhënave bazuar në një numër variablash (ato që ndërlidheshin me objektivat e studimit). Gjithashtu, ato u përdorën për të gjetur modelet, trendet dhe probabilitetet brenda të dhënave të papërpunuara.

4. Rezultatet nga studimi “Promovimi i diversitetit dhe barazisë në Kosovë”

Seksioni i mëposhtëm shpalos rezultatet e intervistave me 1,065 të anketuar lidhur me studimin “Promovimi i diversitetit dhe barazisë në Kosovë”, ku u përfshinë të anketuar nga të gjitha etnitë në Kosovë. Ky hulumtim trajtoi tema të ndryshme, përfshirë situatën e përgjithshme lidhur me modelet e diskriminimit në Kosovë dhe vlerësoi ndikimin që kishte shpërthimi i COVID-19 në ndryshimin e këtyre modeleve.

4.1. Profili demografik i të anketuarve

Mostra përbëhej nga 53% burra dhe 47% gra, që kryesisht u përkisnin grupmoshës 25 – 34 (24%), ndjekur nga grupmosha 18 - 24 (22%). Gjithashtu, shumica e të anketuarve kishin përfunduar shkollimin e mesëm 4-vjeçar (53%) dhe ishin të punësuar me kohë të plotë në sektorin privat (26%). Pak më shumë të anketuar vinin nga zonat rurale (53%) se sa ato urbane (47%). Në mesin e të anketuarve të intervistuar, 77% ishin shqiptarë, 14% ishin serbë dhe 8% ishin të tjerë. Sidoqoftë, sikurse vërejtëm më lart, set i të dhënave u peshua në bazë të etnisë dhe grupmoshës për të pasqyruar me saktësi shpërndarjen e popullsisë.

4.2. Perceptimi i përgjithshëm për diskriminimin në Kosovë

Për fillim, ishte e rëndësishme të vlerësohej mendimi i të anketuarve lidhur me praninë e diskriminimit që kishin vërejtur në Kosovë. Prandaj, ky seksion i pyetësorit synonte të

zbulonte perceptimin e përgjithshëm që të anketuarit kishin rreth diskriminimit, kategoritë dhe bazat më të prekura, përvojat personale, veprimet që ata kishin ndërmarrë në rastet e diskriminimit dhe vetëdijen e përgjithshme ndaj të drejtave që i mbrojnë ata nga diskriminimi.

Grafiku vijues tregon nivelin e diskriminimit në Kosovë sipas të anketuarve të intervistuar. Pothuajse gjysma e të anketuarve (48%) deklaruan se diskriminimi është i pranishëm në një masë të moderuar/të madhe në Kosovë (përkatësisht 27% dhe 21%). Në të kundërt, sikurse ilustrohet në figurën më poshtë, një numër pothuajse i barabartë i pjesëmarrësve (40%) deklaruan që diskriminimi ishte i pranishëm në një masë të vogël. Numri i atyre që besonin se diskriminimi nuk është fare i pranishëm në Kosovë ishte i ulët (4%).




Figura 1. Në përgjithësi, sipas pikëpamjes tuaj, deri në ç'masë është i pranishëm diskriminimi në Kosovë?

I shpërndarë sipas etnisë, mund të shihet se etni të ndryshme në Kosovë kanë mendime të ndryshme kur pyeten se deri në ç'skallë ata mendojnë se diskriminimi është i pranishëm në Kosovë. Pothuajse gjysma e shqiptarëve-K (48%) kanë thënë se diskriminimi është i pranishëm në masë të moderuar/madhe, ndërsa 29% e serbëve-K dhe 52% e të tjerëve-K kanë thënë të njëjtën.




Figura 2. Në përgjithësi, sipas pikëpamjes tuaj, deri në ç'masë është i pranishëm diskriminimi në Kosovë? Sipas etnisë

Më tutje, ky studim dha informacion për nivelin e diskriminimit mbi baza të ndryshme. Në bazë të rezultateve, një numër i barabartë i qytetarëve kanë deklaruar se diskriminimi është më mbizotërues për gjini dhe etni/nacionaliteti (19%). Ndërkohë, kjo u pasua nga mendime të ndryshme politike (16%), niveli arsimor ose i të ardhurave (14%) dhe mosha (11%). Për më tepër, një numër i vogël i të anketuarve deklaruan se diskriminimi ishte mbizotërues mbi baza si raca (6%), aftësia e kufizuar (5%) dhe feja (4%).




Figura 3. Në përgjithësi, mbi cilat baza në vijim besoni se diskriminimi mbizotëron më shumë?

Ndërsa shumica e serbëve-K dhe të tjerëve-K besojnë se diskriminimi kryesisht ndodh mbi baza të etnisë/nacionalitetit, dy herë më shumë serbë-K (71%) e thonë këtë në krahasim me të tjerë-K (38%). Nga ana tjetër, vetëm 16% e shqiptarëve-K besojnë të njëjtën. Në këtë drejtim, një në katër shqiptarë-K (21%) ka thënë se diskriminimi kryesisht është mbizotërues për shkak të gjinisë.




Figura 4. Në përgjithësi, mbi cilat baza në vijim besoni se diskriminimi mbizotëron më shumë? Sipas etnisë

Të anketuarit e gjinive të ndryshme kanë mendime të ndryshme se mbi cilat baza njerëzit diskriminohen më shpesh. Sikurse paraqet figura më poshtë, 27% e grave besojnë se diskriminimi bëhet kryesisht mbi baza të gjinisë, që është më shumë se dy herë se burrat (12%). Ndërsa, 19% e burrave besojnë se diskriminimi ndodh kryesisht për shkak të mendimit të ndryshëm politik; një opsion i zgjedhur nga 13% e grave.




Figura 5. Në përgjithësi, mbi cilat baza në vijim besoni se diskriminimi mbizotëron më shumë? Sipas gjinisë

Në këtë kontekst, pyetësi adresoi edhe fushat specifike ku mund të ketë mbizotërim të lartë të diskriminimit. Në këtë rast, më shumë se gjysma e të anketuarve (59%) e konsideruan punësimin si një nga fushat me mbizotërimin më të lartë të diskriminimit. Më pak të anketuar besonin se diskriminimi ishte i pranishëm në fushat e mëposhtme si qasja në kujdesin shëndetësor (14%), arsimi (8%), sistemi gjyqësor (8%) dhe shërbimet publike (6%).




Figura 6. Në përgjithësi, në cilën nga kategoritë e mëposhtme besoni se mbizotëron diskriminimi?

Gjatë hulumtimit, të anketuarit patën mundësinë të deklarojnë rastet personale të diskriminimit. Në këtë drejtim, vetëm 9% e tyre raportuan se kishin qenë viktimë të diskriminimit në 12 muajt e fundit, që është tregues i qartë për vetëdijësimin e ulët se çfarë është diskriminim ose/dhe kujt t'i drejtohen me ankesë.




Figura 7. Gjatë 12 muajve të fundit, a keni qenë viktimë e diskriminimit, për çfarë arsyeje?

Të anketuarit të cilët thanë se kanë përjetuar diskriminim vitin e kaluar, u pyetën më tej se ku e kishin përjetuar diskriminimin. 36% deklaruan se kishin qenë në punë, rreth një e katërta e të anketuarve (24%) listuan situata të tjera, si gjatë kujdesit shëndetësor. 18% thanë se diskriminimi ndodhi gjatë aplikimit për vend pune.




Figura 8. Në çfarë situatë ishit kur përjetuat diskriminimin?

Në lidhje me përvojën personale të diskriminimit, të anketuarit gjithashtu patën mundësinë të komentonin mbi veprimet e ndërmarra kundër aktit të diskriminimit. Shumica e tyre (67%) pohuan se nuk kishin bërë asgjë, ndërsa 14% se kishin biseduar me dikë se çfarë të bënin në atë situatë dhe 10% kishin shprehur zemërim ndaj personit që kishte shkaktuar problemin. Arsyeja e mosndërmarrjes së veprimeve kundër rasteve të diskriminimit mund të arsyetohet nga mosbesimi i tyre ndaj shtetit, ku një pjesë e madhe e tyre deklaruan se kishin disi /aspak besim te shteti, kur bëhej fjalë për t'i mbrojtur ata nga diskriminimi.




Figura 9. Çfarë veprimesh ndërmoret?

Tabela e mëposhtme paraqet arsyet kryesore pse të anketuarit besonin se kishin hasur në diskriminim. Sikurse shihet, 21% e tyre e kishin konsideruar gjininë si arsyen kryesore të diskriminimit të tyre. Kjo ndiqet nga një rezultat i barabartë për etninë/nacionalitetin dhe mendimin e ndryshëm politik (17%). Sidoqoftë, një numër jo shumë më i vogël i tyre kanë raportuar nivelin e arsimit ose të të ardhurave (16%) dhe moshën (13%) si arsye për diskriminimin ndaj tyre.




Figura 10. Cila mendoni se ishte arsyeja kryesore që u përballët me diskriminim?

Kur jemi tek përjetimi i diskriminimit, më shumë të tjerë-K (15%), më shumë se shqiptarë-K (9%) dhe serbë-K (8%) kanë thënë se i kanë diskriminuar në 12 muajt e fundit. Figura në vijim tregon se shumica e serbëve-K (67%) dhe të tjerëve-K (64%) që i kanë diskriminuar, besojnë se kjo ka ndodhur për shkak të etnisë/nacionalitetit të tyre, sikurse deklarohet nga vetëm 11% shqiptarë-K. 23% e shqiptarëve-K mendojnë se janë diskriminuar për shkak të gjinisë.




Figura 11. Cila mendoni se ishte arsyeja kryesore që u përballët me diskriminim? Sipas etnisë

Në total, 10% e burrave dhe 8% e grave kanë raportuar se kanë përjetuar diskriminim në vitin e fundit. Kur u pyetën se mbi cilën bazë, më shumë gra (44%) se sa burra (7%) thanë se ishte për shkak të gjinisë. Nga ana tjetër, 24% e burrave thanë se kjo ishte për shkak të etnisë/nacionalitetit dhe 22% thanë se ishte për shkak të mendimit ndryshe politik; sikurse thanë 5% dhe 8% e grave përkatësisht.




Figura 12. Cila mendoni se ishte arsyeja kryesore që u përballët me diskriminim? Sipas gjinisë

Duke patur parasysh se ky hulumtim synon të rrisë vetëdijësimin për barazinë dhe diversitetin në radhët e popullsisë, pyetësi gjithashtu ka adresuar njohuritë e të anketuarve për të drejtat e tyre në rastet e diskriminimit. Më pak se gjysma e të anketuarve (44%) raportuan se nuk kishin njohuri për të drejtat e tyre në rastet e diskriminimit, ndërsa 43% pohuan të kundërtën.




Figura 13. A i dini se cilat do të ishin të drejtat tuaja në rast se bëheni viktimë e diskriminimit?

Kur u pyetën nëse e dinin se cilat do të ishin të drejtat e tyre po t'i diskriminonin, vetëm 10% e serbëve-K u përgjigjën pozitivisht, ndërsa 46% e shqiptarëve-K dhe 33% e të tjerëve-K u shprehën njësor.




Figura 14. A i dini se cilat do të ishin të drejtat tua në rast se bëheni viktimë e diskriminimit? Sipas etnisë

Pavarësisht informacionit që mund të kenë për të drejtat e tyre, të anketuari patën mundësinë të tregojnë se kujt do t'i drejtoheshin nëse do të ishin viktimë e diskriminimit. Pak më shumë se gjysma e tyre (54%) thanë se do t'i drejtoheshin policisë dhe 24% e tyre thanë se do t'i drejtoheshin gjykatave.




Figura 15. Nëse do t'ju ndodhte diskriminimi, kujt do t'i drejtoheshit?

Po ashtu, në përgjithësi më shumë se gjysma e të anketuarve pohojnë se asnjë nga situatat e listuara më poshtë nuk u ka ndodhur ndonjëherë. Për shembull, 69% thanë se nuk janë kërcënuar/ngacmuar asnjëherë për shkak të gjinisë, nacionalitetit, fesë, besimit politik, moshës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, etj. Për më tepër, 67% thanë se kurrë nuk i kanë sharë apo ofenduar për shkak të pikave të përmendura më lart. Sidoqoftë, më pak se gjysma e të anketuarve (48%) nuk janë trajtuar kurrë me më pak respekt se sa të tjerët për shkak të karakteristikave të tyre, ndërsa 22% e kanë përjetuar atë më pak se një herë në vit dhe rreth një në pesë (19%) e përjetojnë atë disa herë në vit.

Tabela 1. Në jetën tuaj të përditshme, sa shpesh ju ka ndodhur cilado nga pikat më poshtë?

	Pothuajse çdo ditë	Së paku një herë në javë	Disa herë në muaj	Disa herë në vit	Më pak se një herë në vit	Kurrë
Ju trajtojnë me më pak respekt se sa të tjerët për shkak të gjinisë, nacionalitetit, fesë, besimit politik, moshës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, etj.	1%	4%	6%	19%	22%	48%
Ju japin shërbim më të keq se sa të tjerëve në restorante ose dyqane për shkak të gjinisë, nacionalitetit, fesë, besimit politik, moshës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, etj.	1%	3%	12%	13%	13%	57%
Njerëzit sillen sikur mendojnë se nuk jeni të zgjuar për shkak të gjinisë, nacionalitetit, fesë, besimit politik, moshës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, etj.	0.2%	2%	6%	16%	17%	59%
Njerëzit sillen sikur kanë frikë nga ju për shkak të gjinisë, nacionalitetit, fesë, besimit politik, moshës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, etj.	1%	2%	9%	12%	11%	65%
YouJu shajnë ose ofendojnë për shkak të gjinisë, nacionalitetit, fesë, besimit politik, moshës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, etj.	1%	3%	7%	12%	12%	67%

Kur u pyetën për përvojën e tyre personale me diskriminimin, padrejtësinë ose trajtimin e keq bazuar në arsye të ndryshme në çfarëdo kohe të jetës së tyre, rezultatet nuk ishin aq të ndryshme nga njëri-tjetri. Në këtë drejtim, 20% e të anketuarve deklaruan se u ishte refuzuar një vend pune për arsye të tilla si gjinia, nacionaliteti, feja, besimi politik, mosha, aftësia e kufizuar, orientimi seksual, etj, ndërsa 16% e tyre deklaruan se nuk u ishin dhënë të njëjtat mundësi si të tjerëve në arsim për shkak të të njëjtave arsye. Po ashtu, më pak të anketuar deklaruan se u ishte mohuar një shërbim (si strehimi publik)/kujdes mjekësor ose se janë pushuar padrejtësisht nga puna bazuar në arsytet e lartpërmendura (përkatësisht 10% dhe 11%).




Figura 16. Gjatë jetës suaj, a mendoni se keni qenë:

Në përgjithësi, 67% e të anketuarve kanë deklaruar se diskriminimi u ka ndikuar disi/pak që të kenë jetë të përmbushur dhe produktive. Kur shqyrtojmë përgjigjet ekstreme në këtë rast, 29% kanë raportuar se diskriminimi nuk ka ndikuar aspak në jetët e tyre dhe vetëm pesë përqind kanë raportuar se kishte ndikuar shumë që ata të kishin jetë të përmbushur dhe produktive.




Figura 17. Në përgjithësi, sa ka ndikuar diskriminimi që të keni jetë të plotë dhe produktive?

Po ashtu, të anketuarit patën mundësinë të tregojnë nëse njihnin dikë që kishte qenë viktimë e diskriminimit. Sikurse ilustron në figurën më poshtë, rezultatet tregojnë se 31% e tyre janë përgjigjur pozitivisht në këtë rast.




Figura 18. A njihni dikë (shok/familjar) që ka përjetuar diskriminim?

Për më tepër, rezultatet kanë treguar se gjinia dhe mosha ishin arsyt kryesore që të anketuarit mendonin se shokët/familjarët ishin viktime të diskriminimit (përkatësisht 24% dhe 23%).




Figura 19. Cila ka qenë arsyeja kryesore për atë?

Pavarësisht përvojave të tyre personale me diskriminimin, ky studim gjithashtu pati për qëllim të vlerësojë nëse të anketuarit ishin në dijeni të Ligjit nr. 05/l-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Më shumë se gjysma e tyre (57%) raportuan se nuk ishin në dijeni të këtij ligji, ndërsa 30% deklaruan se ishin.




Figura 20. A jeni në dijeni të Ligjit nr. 05 / I-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Kosovë?

Rreth një e treta e shqiptarëve-K (31%) ishin në dijeni të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Kosovë, që është gjysëm herë më shumë se të tjerët-K (15%). Në këtë drejtim, vetëm 3% e serbëve-K u përgjigjën pozitivisht.




Figura 21. A jeni në dijeni të Ligjit nr. 05 / I-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Kosovë? Sipas etnisë.

Rezultatet tregojnë se 35% e burrave ishin në dijeni të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi në Kosovë, që është 11 pikë përqindjeje më shumë se sa gratë (24%).




Figura 22. A jeni në dijeni të Ligjit nr. 05 / I-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Kosovë? Sipas gjinisë

Nga ana tjetër, kur të anketuarit u pyetën për njohuritë e tyre lidhur me Avokatin e Popullit, si institucion që trajtojnë parashtresat/pohimet e individëve për diskriminim në Kosovë, 57% e tyre deklaruan se ishin të familjarizuar me të.




Figura 23. A jeni të familjarizuar me Avokatin e Popullit si institucion që trajton parashtresat/pohimet e individëve për diskriminim në Kosovë?

Duke marrë parasysh njohuritë e lartpërmendura për Avokatin e Popullit, të anketuarit gjithashtu u pyetën për gatishmërinë e tyre për të raportuar raste të diskriminimit në këtë institucion. Sikurse paraqitet në figurën më poshtë, më shumë se gjysma e të anketuarve (55%) deklaruan se do të ishin disi/shumë të gatshëm që t'i raportonin rastet e diskriminimit tek ky i fundit; ndërsa 19% e tyre deklaruan se ishin disi/aspak të gatshëm për ta bërë këtë.




Figura 24. Sa të gatshëm do të ishit që rastet e diskriminimit t'i raportonit tek Avokati i Popullit?

4.3. Kontributi i palëve të interesit në luftën kundër diskriminimit

Ndër të tjera, ky studim synon të vlerësojë mendimin e të anketuarve për kontributin e institucioneve në luftën kundër diskriminimit në Kosovë. Për ta bërë një vlerësim të tillë, të anketuarve ju dha mundësia që të vlerësonin në një shkallë nga 1 (më e ulëta) në 5 (më e larta), sa mendonin se institucionit ishin të angazhuara në luftën kundër diskriminimit. 19% e tyre deklaruan se ka patur disi shumë/shumë përpjekje në luftën kundër

diskriminimit. Ndërsa 44% ishin neutralë për këtë temë, 38% besonin se ka patur disipak/aspak përpjekje në luftën kundër diskriminimit.




Figura 25. Në një shkallë nga 1 në 5, sa përpjekje mendoni se janë bërë në Kosovë në luftën kundër diskriminimit?

Kur shqyrtojmë përgjigjet e dhëna lidhur me përpjekjet për luftën kundër diskriminimit, të tjerë-K i renditën më së larti (2.87), në një shkallë nga 1 (aspak) deri 5 (shumë), në krahasim me dy grupet e tjera. Shqiptarët-K i vlerësuan përpjekjet me rreth 2.69, ndërsa serbët-K me vetëm 1.90.




Figura 26. Në një shkallë nga 1 në 5, sa përpjekje mendoni se janë bërë në Kosovë në luftën kundër diskriminimit? Sipas etnisë

Po ashtu, të anketuarit u pyetën për masën në të cilën institucionet e mëposhtme japin kontributin e tyre në luftën kundër diskriminimit, që ata duhej ta vlerësonin në një shkallë nga 1 në 5, ku 1 nënkuptonte aspak kontribut dhe 5 nënkuptonte kontribut i lartë. Edhe pse nuk kishte ndryshime të mëdha në rezultatet e kësaj pyetjeje, shkalla më e lartë ishte 3.05, një vlerësim që iu dha mediave, i ndjekur nga Organizatat Ndërkombëtare (OKB, OSBE, BE, Këshilli i Evropës etj.) me një normë 3.04. Policia u vlerësua me një normë prej 2.98, ndjekur nga institucionet arsimore (2.95), Avokati i Popullit (2.94) dhe OJQ-të (2.92).




Figura 27. Deri në ç'masë e japin institucionet e mëposhtme kontributin e tyre në luftën kundër diskriminimit?

Kur u pyetën për kontributin e palëve të interesit kundër diskriminimit në Kosovë, të anketuarit gjithashtu patën mundësinë të vlerësojnë mbështetjen e tyre ndaj masave dhe veprimeve të drejtuara nga luftimi i diskriminimit për grupe të veçanta. Ata duhej ta bënin këtë vlerësim në një shkallë nga 1 në 5, ku 1 nënkuptonte asnjë mbështetje dhe 5 nënkuptonte mbështetje e plotë. Edhe pse në përgjithësi nuk u identifikuan dallime të mëdha, rezultatet tregojnë se niveli i mbështetjes ndaj veprimeve të ndërmarra ndaj grave (4.43) dhe të varfërve (4.42) renditej më lart, ndërsa LGBT ishte grupi më pak i mbështetur. Ngjashëm, grupet e tjera renditeshin përafërsisht njësoj si dy grupet e lartpërmendura, si personat e moshuar (4.38), personat me aftësi të kufizuara (4.33) dhe personat me asistencë sociale (4.30). Kur merret parasysh aspekti etnik, më pak mbështetje u paraqit ndaj masave të marra për komunitetin serb (3.72).




Figura 28. Në një shkallë nga 1 deri në 5, në ç'masë i përkrahni masat dhe veprimet e drejtuara ndaj luftës kundër diskriminimit të grupeve në vijim?

Sa i përket masës deri ku institucionet e Kosovës (Qeveria, Parlamenti, Gjyqësori) i mbrojnë komunitetet e mëposhtme në Kosovë nga diskriminimi, shumica e të anketuarve besojnë se institucionet po bëjnë një punë të mirë për të gjitha komunitetet e përmendura më poshtë. Shumica e të anketuarve (74%) besonin se institucionet e Kosovës po e mbrojnë mirë komunitetin serb nga diskriminimi, ndërsa më pak të anketuar (56%) thanë të njëjtën gjë për komunitetin rom.




Figura 29. A besoni se institucionet e Kosovës (Qeveria, Parlamenti, gjyqësori) i mbrojnë mirë nga diskriminimi komunitetet e mëposhtme që jetojnë në Kosovë?

Figura e mëposhtme përshkruan nivelin e besimit që të anketuarve kanë se shteti do t'i mbronte ata nga diskriminimi. Gjithsej 40% e të anketuarve deklaruan se kishin disi/aspak besim në shtet kur bëhej fjalë për t'i mbrojtur ata nga diskriminimi, krahasuar me 9% që deklaruan se kishin besim disi të lartë/të lartë. Gjysma e tyre (51%) as nuk tregonin besim, as mosbesim.




Figura 30. Si do ta vlerësonit besimin tuaj se shteti do t'ju mbrojë nga diskriminimi?

Sa i përket miqësisë, të anketuarit u pyetën në mënyrë specifike nëse kishin miq që i përkisnin një moshe, besimi politik, aftësie të kufizuar, orientimi seksual ose nacionaliteti tjetër. Shumica e tyre (përkatësisht 83% dhe 80%) raportuan se kishin miq të moshave të tjera dhe me besime të ndryshme politike. Më tutje, gati gjysma e të anketuarve (45%) deklaruan se kishin miq me aftësi të kufizuara. Mirëpo vetëm 11% deklaruan se kishin miq të gjinisë së njëjtë me orientim seksual tjetër. Së fundmi, shumica dërrmuese (97%) raportuan se nuk kishin miq që i përkisnin një nacionaliteti tjetër.




Figura 31. A keni miq që i përkasin një tjetri..?

Me qëllim të eksplorimit më të thellë në nivel të barazisë dhe diversitetit që është i pranishëm në Kosovë, të anketuarit u pyetën për gatishmërinë e tyre për të jetuar në të njëjtin qytet/fshat/rrugë me grupe të ndryshme njerëzish, për gatishmërinë për të punuar në të njëjtin vend dhe për të patur marrëdhënie martesore me ta. Edhe pse pati një shumicë përgjigjesh pozitive kur u pyetën për të jetuar në të njëjtin qytet/fshat/rrugë dhe të punonin në të njëjtin vend me grupet e përmendura më poshtë, e njëjta nuk mund të thuhet kur

bëhej fjalë për të jetuar me serbë ose LGBTI. Vetëm gjysma e të anketuarve deklaruan se do të jetonin në të njëjtin qytet/fshat/rrugë me serbët (përkatësisht 55% dhe 46%), dhe personat LGBTI (përkatësisht 52% dhe 42%).

Për më tepër, këto rezultate ishin shumë të ndryshme kur bëhej fjalë për të pasur marrëdhënie martesore me persona nga grupet e përmendura në tabelën më poshtë. Për shembull, 92% deklaruan se do të kishin marrëdhënie martesore me shqiptarë dhe 84% me persona me përkatësi të ndryshme politike, ndërsa më pak të anketuar deklaruan se do të kishin marrëdhënie martesore me persona të një feje tjetër. Mirëpo kjo përqindje ishte dukshëm më e ulët kur bëhej fjalë për martesë me turq (17%), persona me aftësi të kufizuara (17%), boshnjakë (16%), goranë 13%, romë (8%), ashkali (8%), egjiptianë (8%) dhe serbë (7%).

Tabela 2. A pajtoheni apo nuk pajtoheni me deklaratat e mëposhtme?

	Të jetoj në të njëjtin qytet/fshat me	Të jetoj në të njëjtën rrugë me	Të punoj në të njëjtin vend pune me	Të kem marrëdhënie martesore me
Shqiptarë	99%	99%	99%	95%
Komuniteti rom	84%	79%	77%	8%
Komuniteti ashkali	79%	74%	72%	8%
Komuniteti egjiptian	81%	75%	78%	8%
Komuniteti serb	55%	46%	44%	7%
Komuniteti boshnjak	86%	83%	83%	16%
Komuniteti turk	88%	86%	87%	17%
Komuniteti goran	84%	79%	78%	13%
Persona me aftësi të kufizuara	97%	97%	95%	17%

LGBT	52%	42%	42%	1%
Persona me përkatësi të ndryshme politike	98%	98%	97%	84%
Persona me fe të ndryshme	98%	98%	96%	40%

Tabeka 3. A pajtoheni apo nuk pajtoheni me deklaratat e mëposhtme? Sipas etnisë

		Shqiptarë	Romë	Ashkali	Egjiptianë	Serbë	Boshnjakë	Turq	Goranë
Shqiptarë-K	Të jetoj në të njëjtin qytet/fshat me	100%	83%	78%	80%	52%	86%	88%	83%
	Të jetoj në të njëjtën rrugë me	100%	77%	73%	74%	43%	82%	85%	77%
	Të punoj në të njëjtin vend pune me	100%	77%	71%	77%	41%	82%	87%	78%
	Të kem marrëdhënie martesore me	100%	7%	6%	6%	4%	16%	16%	13%
Serbë-K	Të jetoj në të njëjtin qytet/fshat me	79%	84%	75%	80%	100%	88%	86%	99%
	Të jetoj në të njëjtën rrugë me	84%	83%	75%	74%	100%	93%	91%	95%
	Të punoj në të njëjtin vend pune me	80%	75%	70%	72%	100%	87%	84%	59%
	Të kem marrëdhënie martesore me	6%	3%	2%	4%	100%	9%	3%	16%
Të tjerë-K	Të jetoj në të njëjtin qytet/fshat me	99%	96%	98%	94%	70%	98%	100%	98%
	Të jetoj në të njëjtën rrugë me	99%	96%	98%	94%	64%	98%	100%	98%
	Të punoj në të njëjtin vend pune me	99%	93%	98%	91%	68%	96%	96%	89%
	Të kem marrëdhënie martesore me	71%	38%	54%	44%	6%	50%	50%	38%

Më tutje, të anketuarit u pyetën edhe për shkallën e diskriminimit që vuanin grupet e mëposhtme në baza ditore, në një shkallë nga 1 (shkalla më e ulët) në 5 (shkalla më e lartë). Rezultatet tregojnë se grupi më i diskriminuar konsideroheshin të varfërit (3.94), ndjekur nga të moshuarit (3.84) dhe gratë (3.79). Në anën tjetër, më pak të diskriminuara u konsideruan komunitetet serbe (2.62) dhe turke (2.95)




Figura 32. Deri në ç'masë besoni se grupet në vijim diskriminohen në baza ditore në Kosovë?

Njëra nga pyetjet krijoi mundësinë për ta shtjelluar më tej nivelin e diskriminimit në kategori të ndryshme mbi baza të ndryshme. Bazuar në rezultatet, 83% e të anketuarve besojnë se diskriminimi në punësim bazohet në besimin politik, dhe 77% e tyre besojnë se bazohet në gjini. Për më tepër, kur bëhet fjalë për kategori të ndryshme të tilla si arsimi, qasja në strehim, qasja në kujdesin shëndetësor, qasja në shërbimet publike dhe qasja në sistemin gjyqësor, më shumë se gjysma e të anketuarve e konsiderojnë bindjen politike si arsye të diskriminimit në këto kategori.

Tabela 4. Sipas mendimit tuaj, a ka diskriminim në bazë të?

	Punësim	Arsim	Qasje në strehim	Qasje në kujdes shëndetësor	Qasje në shërbime publike	Qasje në sistemin gjyqësor
Gjinia seksi	77%	58%	42%	41%	40%	42%
Nacionaliteti	61%	49%	42%	41%	40%	38%
Feja	34%	31%	25%	24%	24%	24%
Besimi politik	83%	70%	73%	67%	62%	61%
Mosha	53%	36%	28%	42%	30%	35%
Aftësia e kufizuar	76%	62%	46%	52%	49%	53%
Orientimi seksual	32%	27%	22%	22%	19%	21%

4.4. Efektet e COVID-19 mbi modelet e diskriminimit

Pandemia e COVID-19 ndikoi tek të gjithë. Qeveritë kanë marrë masa urgjente për të frenuar përhapjen e saj në mënyrë që të mbrojnë shëndetin publik dhe të sigurojnë kujdes mjekësor për ata që kanë nevojë. Këto masa pashmangshmërisht kufizojnë të drejtat themelore në atë shkallë që rrallë përjetohet në kohë paqeje. Është me rëndësi të sigurohet që kufizime të tilla janë në përputhje me masat mbrojtëse ligjore dhe që ndikimi i tyre në grupe të veçanta të merret parasysh si duhet.

Thënë këtë, përveç vlerësimit të situatës së përgjithshme lidhur me modelet e diskriminimit në Kosovë, ky studim ofroi edhe një mundësi për të vlerësuar ndikimin e pandemisë COVID-19 në ndryshimin e këtyre modeleve.

Për ta zgjeruar të kuptuarit rreth efektit të COVID-19 mbi modelet e diskriminimit, të anketuarit patën mundësinë të vlerësojnë nëse niveli i diskriminimit ose numri i rasteve ishte rritur, kishte mbetur i njëjtë apo ishte ulur gjatë pandemisë.

Në bazë të rezultateve, 39% e të anketuarve deklaruan se ky nivel kishte mbetur i njëjtë, ndërsa pothuajse i njëjti numër deklaroi se nuk e dinte/refuzonte të përgjigjej për këtë çështje (31%). Sidoqoftë, numri i atyre që besonin se niveli i diskriminimit gjatë pandemisë COVID-19 ishte rritur ishte edhe më i vogël (24%).




Figura 33. A besoni se numri i rasteve të diskriminimit gjatë pandemisë së COVID-19 është...?

Kështu, të anketuarit që deklaruan se kishte pasur rritje/ulje të nivelit të diskriminimit gjatë pandemisë COVID-19, u pyetën më tej specifikisht për këto nivele ndaj grupeve të ndryshme. Bazuar në përgjigjet e të anketuarve, dy grupet kryesore kundër të cilave ishte rritur niveli i diskriminimit ishin të varfërit (43%) dhe gratë (41%), të ndjekura nga njerëzit në asistencë sociale dhe të moshuarit (përkatësisht 38% dhe 36%). Në raste të tjera, më shumë se gjysma e të anketuarve besonin se niveli i diskriminimit ndaj grupeve të përmendura kishte mbetur i njëjtë edhe gjatë pandemisë.




Figura 34. Për shkak të COVID-19, për cilat nga grupet në vijim, është rritur, ulur, apo ka mbetur njësoj, niveli i diskriminimit?

5. Konkluzionet

Rezultatet e këtij studimi, përveç identifikimit të perceptimit të publikut të gjerë dhe përvojave të drejtpërdrejta me shkeljen e të drejtave të njeriut, si dhe njohurive dhe vlerësimit nga ana e tyre për punën e institucioneve për të drejtave e njeriut në Kosovë, sjell udhëzim për të gjitha institucionet përkatëse, përfshirë Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, lidhur me zbatimin efektiv të Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky studim adreson gjithashtu temën e ndikimit që ka patur potencialisht shpërthimi i COVID-19 mbi modelet e diskriminimit.

Në përgjithësi, rezultatet e studimit tregojnë se shumica e të anketuarve besojnë se në Kosovë diskriminimi është i pranishëm; një mendim që kryesisht bashkëndahet nga të intervistuarit. Më konkretisht, bazuar në përvojat e tyre personale dhe atyre përreth, ata deklarojnë që mbizotërimi i tij është më i lartë kur bëhet fjalë për gjininë, moshën dhe etninë/nacionalitetin dhe është më mbizotërues në punësim. Sidoqoftë, shumica e tyre deklarojnë se kjo nuk ndërhyr në jetën e tyre të përditshme.

Studimi gjeti se vetëdijësimi i qytetarëve për diskriminimin dhe niveli i informacionit për të drejtat e tyre nëse do të ishin viktimat të diskriminimit është përgjithësisht i ulët. Kur flisnim për institucionet ku do të referoheshin qytetarët në raste diskriminimi, shumica e të anketuarve përmendën Policinë dhe gjykatat. Po ashtu, më shumë se gjysma e të anketuarve ishin të familjarizuar me Avokatin e Popullit dhe gjysma e tyre do të ishin të gatshëm t'i raportonin rastet e diskriminimit në këtë institucion.

Ajo çka ndihmon në luftimin e diskriminimit dhe ngritjen e nivelit të barazisë dhe diversitetit është kontributi i institucioneve të ndryshme në Kosovë. Sidoqoftë, më pak se një e pesta e qytetarëve besojnë se ka patur disi shumë/shumë përpjekje në luftën kundër diskriminimit. Media dhe organizatat ndërkombëtare (OKB, OSBE, BE, Këshilli i Evropës, etj.) konsiderohet se kanë kontribuar më së shumti në luftën kundër diskriminimit. Në të njëjtën kohë të intervistuarit në përgjithësi shfaqin një nivel të ulët të besimit ndaj shtetit për t'i mbrojtur ata nga diskriminimi.

Gjatë matjes së qëndrimeve ndaj grupeve të ndryshme, të intervistuarit tregojnë një nivel të lartë të pranimit ndaj diversitetit kur jetojnë në të njëjtin qytet/fshat/rrugë dhe kur punojnë në të njëjtin vend me grupe të ndryshme njerëzish. Fatkeqësisht, ky nivel i pranimit nuk haset kur konsiderohet mundësia e marrëdhënieve martesore me njerëz nga ato grupe specifike. Më tej, studimi gjithashtu zbuloi se shumica dërrmuese (97%) raportuan se nuk kishin miq që i përkisnin një nacionaliteti tjetër.

Së fundmi, kur identifikohet ndikimi i pandemisë COVID-19 mbi modelet e diskriminimit, rezultatet tregojnë se një numër i lartë i qytetarëve besojnë se numri i rasteve të diskriminimit ka mbetur i njëjtë. Për ata që besojnë se diskriminimi është rritur që atëherë,

ata kryesisht mendojnë kështu për të varfërit, gratë, ata me asistencë sociale dhe të moshuarit.

KONTAKTET:

z. Habit Hajredini

Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit

+383 3820014070

habit.hajredini@rks-gov.net

znj. Armenda Shala

Zyrtare e Lartë për Mbrojtje nga Diskriminimi, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit

+383 3820014642 +383 49397776

armenda.berani@rks-gov.net

Facebook: Office of Good Governance- Office of the Prime Minister in Kosovo

Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund të merren se pasqyrojnë mendimin zyrtar të cilësdo palë.

Këshilli i Evropës është organizata lidere për të drejtat e njeriut e kontinentit. Ai përbëhet nga 47 shtete anëtare, ku përfshihen të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë dhënë nënshkrimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbikëqyr implementimin e Konventës në shtetet anëtare. www.coe.int	Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur t'i bëjnë bashkë njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Bashkërisht, kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i përkushtuar për t'i ndarë arritjet dhe vlerat e veta me vende dhe popuj përtej kufijve të vet. www.europa.eu
---	--

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës